



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E TURIZMIT
DHE MJEDISIT
INSPEKTORATI SHTETËROR I MJEDISIT PYJEVE UJËRAVE DHE TURIZMIT**

Nr. 6272 Prot

Tiranë 08.11.2018

NJOFTIM

PËR SHPALLJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT TË KËRKESAVE

“PËR SHËRBIMIN PËRMBARIMOR PRIVAT”

Në mbështetje të Ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 “ Për kundravajtjet administrative” Ligji nr.10031, datë 11.12.2008 “ Për shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat”, Vendimit Nr.103 datë 4.5.2015 “*Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave*” i ndryshuar me vendimin nr.338 datë 6.6.2018 të Këshillit të Ministrave.

Në kuadër të procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutiv me qëllim vjeljen e gjobave të vendosura nga strukturat përkatëse të institucionit, dhe në mbështetje të parimeve dhe objektivave bazë për rregullimin e veprimtarisë së inspektimit Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Pyjeve Ujërave dhe Turizmit njofton palët e interesuara;

1. Të paraqesin kërkesën e tyre për bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit Pyjeve Ujërave dhe Turizmit me qëllim ekzekutimin e titujve ekzekutiv.
2. Të drejtën për të paraqitur kërkesën për bashkëpunim e kanë ata përmbarues privat që plotësojnë këto kritere të përgjithshme :
 - a. Të disponojë certifikatë “Për ushtrimin e veprimtarisë si përmbarues gjyqësor privat”
 - b. Liçensë nga “Qendra Kombëtare e Liçensimit”
 - c. Certifikatë regjistrimi nga QKB
3. Të kenë eksperiencë profesionale në fushën respektive
4. Veprimtaria të ketë fushë mbulimi në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë

5. Dokumentacioni që kërkohet për t'u depozituar dhe protokolluar në ISHMPUT, duhet të përmbajë:
- Kërkesën me shkrim për bashkëpunim
 - Dokumente të tjera të disponueshme nga përmbaruesi gjyqësor privat
 - Vërtetim të gjëndjes gjyqësore
6. Afati i pranimit të dokumentacionit fillon në datë 08.11.2018 dhe përfundon më datë 14.11.2018
7. Kërkesa duhet të depozitohet në adresën e ISHMPUT, Blv "Zhan D'Dark" Ish Godina e ATSH, Tiranë.

KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj

